

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit Arben Hoti, në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues, me sekretaren juridike Ibadete Zullufi, në lëndën penale kundër të pandehurit V. E., për shkak të veprave penale; vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë mendore nga neni 180 i KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në Pronësi, Kontrollë Ose Posedim ta Pa autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.957/2015 të dt.24.05.2016, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 24.06.2016, në të cilin shhyrtim kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit Ilaz Beqiri, përfaqësuesi i palës së dëmtuar A. A., me përfaqësuesin e tij të autorizuar av.N. R., i pandehuri V. E. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.T. Rr., me datë 27.06.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri **V.E.**, nga i ati N. dhe nëna S., e gjinisë P., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin M. Komuna O., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i një fëmije, student i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I.

Me datë 07.12.2015, rreth orës 00:40, afër shtëpisë të të pandehurit V. E., që gjendet në fshatin M. Komuna O., i pandehuri në gjendje të afektit të rëndë mendor, ka privuar nga jeta burrin e motrës së tij A., tani të ndjerin N. A., në atë mënyrë që, pasi i ndjeri kishte përzënë nga shtëpia bashkëshorten e tij A. E., e pas shumë telefonatave dhe sms-ve, të shkëmbyera në mes veti, së fundi tani i ndjeri i kërcënon A. dhe babain e saj N. E., duke i'u drejtuar me fjalët “po vijë e po ju faroj krejtve”, niset nga P. në drejtim të shtëpisë së të pandehurit, me veturën e tipit “Pezho”, ngjyrë e gjelbër me targa *numër i targave...*, A. dhe N. ndihen të rrezikuar, lajmërojnë policinë në O. dhe Stacionit Policorë Veriu në Prishtinë se janë të rrezikuar, mirëpo tani i ndjeri arrin që të shkoj në vendin e ngjarjes para policisë, ofrohet tek dera e hyrjes së shtëpisë së N. dhe për të biseduar me të del A., i ndjeri e kap atë për flokësh, e tërheq në drejtim të veturës të cilën e kishte ndalur mbrapa shtëpisë së N., A. bërtet dhe po sa prindërit e saj e dëgjojnë duke bërtitur, e para në oborr del nëna e A., S. e menjëherë pas saj edhe babai N., S. i drejtohet të ndjerit me fjalët: “lëshoje qikën se e myte” dhe ofrohet tek i ndjeri, ai e godet me grusht në fytyrë S. e cila rrëzohet në tokë, dhe nga hunda dhe goja i rrjedhë gjak, tani edhe N. kërkon nga i ndjeri që ta lëshon A., mirëpo i ndjeri tenton ta godasë, i cili duke u larguar rrëzohet në tokë, dhe në ato çaste nga shtëpia del i pandehuri V. E. i cili në ato momente kishte qenë fjetur, i ofrohet tani të ndjerit dhe kërkon ta liroj A., dhe me revole të tipit “M57” e kal.7.62mm, me nr.serik N-160469, nga afërsia, shtënë dy herë në drejtim të të ndjerit dhe i shkakton dy plagë vdekjeprurëse, njëra në regjionin e veshit të djathtë, plagë tej shkuese, dhe plagë në anën e majtë të qafës, i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes, dhe në ato momente vjen policia, ndërsa i ndjeri vdes rrugës për spital,

- Me këtë ka kryer veprën penale vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë mendore nga neni 180 i KPRK-së

II.

I pandehuri pa autorizim, nga koha e pa përcaktuar deri me datë 07.12.2015, ka poseduar armë dhe atë: revolen e tipit “M57” e kal.7.62mm, me nr.serik N-160469, me të cilën e ka kryer veprën penale si në dispozitivin I të Aktakuzës, si dhe gjatë basitisjes në shtëpinë e të pandehurit janë gjetur dhe sekuestruar, një revole e tipit “Ekol Special” me nr.Serik EV1260093, me një fishek të armës me gas, 6 fishek të revoles, një fishek i pushkës së gjuetisë dhe 57 fishek të kal.7.62 mm,-

- Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim ta pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në nenet e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,45,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, gjykon:

DËNIM ME BURGIM

Të pandehurit **V.E.** I përcakton dënimet si në vijim:

- Për veprën penale sikurse në pikën 1 (një) të dispozitivit të aktgjykimit veprën penale vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë mendore nga neni 180 i KPRK-së dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve,
- Për veprën penale sikurse në pikën 2 (dy) të dispozitivit të aktgjykimit veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontrollë Ose Posedim ta Pa autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj,

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 nënpar. 2.2 gjykata shqipton;

DËNIM UNIK ME BURGIM

Të pandehurit V.E. i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha që qëndrimin në paraburgim prej datës 08.12.2015

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 107.31 euro, si dhe paushallin gjyqësorë në lartësi prej 100 euro, të gjitha këto në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 69 par.1 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së:

Konfiskohen në mënyre të përhershme armët “M57” e kal.7.62mm, me nr.serik N-160469, me të cilën e ka kryer veprën penale si në dispozitivin I të Aktakuzës, si dhe gjatë bastisjes në shtëpinë e të pandehurit janë gjetur dhe sekuestruar, një revole e tipit “Ekol Special” me nr.Serik EV1260093, me një fishek të armës me gas, 6 fishek të revoles, një fishek i pushkës së gjuetisë dhe 57 fishek të kal.7.62 mm

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, A. A. nga P. rr.”H. P.” p.n, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti Për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.957/2015 të dt.24.05.2016, kundër të pandehurit V. E., për shkak të veprave penale; vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë mendore nga neni 180 i KPRK-së, dhe veprës penale Mbjajtja në Pronësi, Kontrollë Ose Posedim ta Pa autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.24.06.2016, në të cilën Prokurori i Shtetit fillimisht ka përmirësuar aktakuzën, ngase është lëshuar gabim teknik në numra, ashtu që si kohë e kryerjes së veprës penale është fshirë viti 2016, ndërsa në vend të tij prokurori e ka përmirësuar në vitin 2015, dhe me pas e ka lexuar aktakuzën PP.I.nr.957/2015 të dt.24.05.2016. Kryetari I Trupit Gjykses pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të pandehurit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri V.E. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, pastaj gjykata me rastin e vlerësimit të fajësisë për të pandehurin ka marrë mendimin fillimisht të Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke konsideruar se ai mjaftueshëm është konsultuar me mbrojtësin e tij, ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, dhe se një pranim i tillë është në përputhëri me të gjitha shkresat e lëndës.*

Mbrojtësi i të pandehurit V. E. av.T. Rr. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: *unë si mbrojtës jamë konsultuar mjaftueshëm me klientin tim, e kam njoftuar me pasojat dhe përfitimet që mund të ketë me pranimin e fajësisë, ashtu që e ka mbështetë në tërësi pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, dhe ka shtuar se ky pranim mbështetet në provate grumbulluara nga prokurori në procedurën paraprake, dhe se ka mbështetje të plotë në dispozitat e KPPK-së.*

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar A. A. vëllai i tani të ndjerit, pasi që gjykata ka kërkuar mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: *kërkoj nga gjykata që të pandehurit mos t'i pranohet fajësia.*

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av.N.R. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: *me keqardhje themi se e kundërshtoj pranimin e fajësisë në këtë fazë, konsideroj se akuza ka mungesa dhe gabime faktike lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, e cila i vihet në barrë tani të akuzuarit, si dhe pushimin e hetimeve lidhur me një vepër tjetër penale, për të cilën në shkresat e lëndës ka prova konkrete, bazuar në këto i njëjti*

ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj pranimin e fajësisë për të pandehurin, dhe që Gjykata të vazhdoj me shyrtimin gjyqësorë.

Meqenëse I pandehuri V. E. e ka pranuar fajësinë, dhe pas marrjes së mendimit të palëve në procedurë, gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, për faktin se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin mbrojtës, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë; Raporti i Autopsisë MA 15-342 nga Eksperti i Mjekësisë Ligjore Dr. A. G., Raportet e Ekspertimit nga Agjencia Kosovare Për Forenzikë e dt.25.02.2016 dhe 26.04.2016, Ekspertiza Psikiatrike për të pandehurin V. E. e dt.11.02.2016, Procesverbali i Bastisjes së Shtëpisë i dt.07.12.2015, foto-dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, aktakuza nuk ka shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë për të pandehurin V. E. për veprat penale, vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë mendore nga neni 180 i KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në Pronësi, Kontrollë Ose Posedim ta Pa autorizuar të Armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e marrjes së aktgjykimit gjykata është kujdesur që në mes aktakuzës dhe aktgjykimit të ekzistoj identiteti subjektiv dhe objektiv i aktgjykimit me aktakuzën konform nenit 360 par.1 të KPPK-së, që do të thotë se aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar, dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori: pranimin e fajësisë nga I pandehuri, keqardhjen e shfaqur të pandehurit të shprehur edhe në seancën e shqyrtimit fillestar, faktin se nuk ka të dhëna se i pandehuri ka qenë më parë i dënuar për vepra penale, ku këto rrethana tregojnë edhe për karakterin e të pandehurit V. E., i njëjti nuk është i predispozuar për kryerjen e veprave penale, sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, ku me dt.31.01.2013 familja e tij konkretisht baba i tij N. E. në njërin anë, dhe A. A. dhe B. A. si palë e dëmtuar, falë aktit fisnik të familjes së dëmtuar, në prezencën e Këshillit të Pajtimit kanë nënshkruar një deklaratë me të cilën kanë zgjidhur ngatërresën në mes tyre, rrethanat personale dhe familjare të pandehurit, i njëjti është i martuar dhe baba i një fëmije.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori dëmtimin e vlerës së mbrojtur, dëmin e shkaktuar me vepër penale, e që në rastin konkret është jeta e ndërprerë para kohe e një njeriu, tani të ndjerit N. A..

Gjykata të pandehurit I përcaktoj dënimet për secilën veprë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, dhe më pas i shqiptoj dënim burgimi unik prej gjashtë viteve, duke marrë për bazë rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 par.1 të KPRK-së, dhe atë në kuptim të preventives speciale dhe ky dënim të ndikoj te i pandehuri që të përmbahet nga përsëritja e veprave penale në të ardhmen, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e sendeve u marr konform nenit 69 par.1 të KPRK –së dhe nenit 115 të KPPK-së, andaj gjykata i ka konfiskuar në mënyrë të përhershme armët “M57” e kal.7.62mm, me nr.serik N-160469, me të cilën e ka kryer veprën penale si në dispozitivin I të Aktakuzës, si dhe gjatë bastisjes në shtëpinë e të pandehurit janë gjetur dhe sekuestruar, një revole e tipit “Ekol Special” me nr.Serik EV1260093, me një fishek të armës me gas, 6 fishek të revoles, një fishek i pushkës së gjuetisë dhe 57 fishek të kal.7.62 mm, si sende – mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u marr konform nenit 450 të KPRK-së, andaj gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 107.31 euro për ekspertizë psikiatrike, si dhe paushallin gjyqësorë në lartësi prej 100 euro, të gjitha këto në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi në lidhje me kërkesën pasurore-juridike është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, andaj gjykata përfaqësuesin e palës së dëmtuar, A.A. nga P. rr.”H. P.” p.n, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e plotë, e as të pjesshëm të kësaj kërkesë.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.322/16, datë 27.06.2016

Sekretarja Juridike:
Ibadete Zullufi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimii është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, prej momentit të marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.